



## **22 Behmen-i, dita e fitores dhe rezistencës**

**Aida K.Pirani**

27 vjet me pare, ne nje dite si kjo, si pasoje e luftes sakrifikuuese dhe trimerore te popullit Iranian dhe udheheqjes se ndritur te imam Khomeinit (ra), themeluesit te Republikes islamike te Iranit, u rrezua sistemi i mvarur mbreterore dhe ne boten dypolare gjate luftes se ftohte ku pavarsia e vertet e nje vendi llogaritej nje ender e parealizueshme, populli iranian arri i ne pavarsi politike me kuptimin e polte te fjalet. Me rastin e pervjetorit te kesaj dite historike, eshte pregaditur nje teme e vecant te cilen po ua prezantoj e vazhdim.

Irani, pershkak te pozites geografike dhe posedimit te rezervave te medha te energjise, qe nga koha e shpuarjes se burimit te pare te naftes ne jug te Iranit ku doli edhe kontigjenti i pare i naftes nga zemra e tokes, u vendos ne qender te vemendjes se fuqive kolonizatore. Ne kete menyre populli iranian i cili shekuj me rradhe ndodhej nen sundimin e sistemeve shtypese mbreterore, u perballte edhe me vjedhjet e kolonizatoreve te huaj. Kjo shtypje historike vazhdoi mbi popullin Iranian edhe pas luftes se dyte botrore, por kesaj rradhe kolonizatoret e huaj ishin me te fuqishem dhe me shtypes se ne te kaluaren duke u shtuar edhe shtypja e mbrendeshme ne menyre te pameshireshme. Bashkimi i vjedhesve te brendeshem dhe te jashtem ne vitete e pas luftes se dyte botrore coi ne grusht shtetin e gushtit te vitit 1953 kunder qeverise legitime te iranit dhe rrezimit te saj dhe qe atehere Amerika sundoi ne sferat politike, ekonomike, ushtarake dhe kulturore te Iranit. Regjimi mbereteror i asaj ate kohe ne Iran, ne te gjitha sferat e lartepermendura ishte i varur nga qeveritaret amerikan dhe para revolucionit islamik ne Iran nuk realizohej asnje plan apo program i madh pa miratimin e shtepise se bardhe. Edhe krengritja e per gjakeshme e vitit 1963 e popullit iranian, nen udheheqjen e imam Khomeinit u shtyp nga ana e regjimit te shahut ne bashkpunim me Ameriken, dhe Irani ne ato dite te zeza morri emrin “ishulli i stabilitetit” nga shtetia e bardhe. Por, perkunder mendimit te qeverise shtypese mbreterore dhe mbeshtetesit e saj amerikan dhe sionsit, nen lekuren e shoqerise iraniene e cila siperfaqesisht dukej e qete digjej nje zjarr i ngjajshem me nje vullkan i cili kerkonte rrugen per te shperthyer ku dhe perfundimishte gjeti ate. Revolucioni islamik, ishte rezulatat i ketij vrulli te cilin imam Khomeini (ra) e ka permendur si shperthim i drites. Imam Khomeini (ra), si lider dhe ideolog i revolucionit islamik, qe nga fillimi i levizjes kunder shtypjes dhe kolonizatoreve te popullit Iranian, vuri theksin mbi moton liri dhe pavarsi dhe Republiken Islamike, e cilesonte si faktor te vetem per realizimin e vertet te kesaj motoje. Sipas pikpamjes se themeluesit te republikes islamike te Iranit, per te arritur pavarsin e vertete, mohimi ne te njejten kohe i sundimit te Lindjes ideologjike dhe Perendimit gjeografik, eshte nje domosdoshmeri e pamohueshme dhe per kete arsy sisitemi i Republikes islamike te Iranit dhe ndjekes i rruges se drejte dhe demokracis fetare, lindi nga brendia e revolucionit islamik.

Rpeublika Islame e Iranit, gjate gjithe cerekshekullit te fudnit ka qene ne shenjester te komploteve te sistemit ekspansionist ne udheheqjen e Amerikes. Pergjate luftes se ftohte ekspertet perendimor moton Jo lindje-jo perendim e konsideronin si nje fenomen te perkotheshem dhe ishin te mendimit se se shpejti revolucioni do te drejtohet drejte se majtes apo te djathes. Kjo pikpamje e gabuar ishte rezultat i mosinformimit te perendimit me thellesine e mendimeve dhe teorive te hazretit imam Khomeini (ra), dhe bindjen e forte te popullit iranian ne liri dhe pavarsi. Sipas pikpmajes se imam Khoeminit (ra), shkolla e islamit, uniteti i popullit dhe udheheqja e klerikeve, ishin

faktoret kryesor te fitores se revolucionit islamik ne Iran. Edhe Ajetullah el Udhma Khomenei, lideri supreme i revolucionit ilsamik te Iranit, keto tre faktor i ka cilesuar si sekret te qendrueshmerise dhe forcimit te sisitemit te Republikes Islamike te Iranit. Ai disa here ka theksuar se shkaku kryesor i iritimt te sisitemit ekspansionist dhe ne vacanti i amerikes me Iranin, eshte qendrueshmeria dhe kundershtimi i ekspansionizmit nga ana e Iranit dhe besnikeria e popullit iranain ndaj bazave dhe idealeve te Revolucionit islamik. Populli iranian me prezencen disa milionesh ne marrshimet ne mbare Iranin me rastin e pervjetorit te revolucionit islamik, edhe njehere do te vene theksin mbi solidaritetin e tyre me Imamin, revolucionin dhe liderin dhe ne te njejten kohe i terheqin verrejtjen armiqeve te vendit dhe sistemit se me te njejtin entuziazem dhe besim qe kishin para 27 vjetesh dhe tani jane te gatshem te shtypin cdo agresion ne token iraniiane dhe te mbrojne vlerat e larta te Islamit dhe Revolucionit islamik. Sipas pikpamjes se popullit dhe funskioanereve Iranian, ceremonia e pervjetorit te fitores se revolucionit islamik nuk eshte vetem nje tradite formale qe ekziston ne shoqerit tjera, por eshte nej epoke e shprehjes se vullnetit te popullit musliman iranian per te jetuar i lire dhe i pavarur nen hijen e sistemit te Republikes Islame te Iranit.

### **Pozita e Revolucionit Islamik te Iranit ne Bote**

Revolucioni Islamik i Iranit, per te cilin Henri Kissinger ish sekretari i jashtem amerikan dhe nje nga personalitetet me te medha amerikane, e ka cilesuar si nje termet te fuqishem, dhe ka qene revolucioni me i madhe i shekullit te 20, i cili ishte aq i fuqishme dhe ndikues sa qe pas 27 vjetesh eshte akoma ne vemendje te studiuseve dhe analisteve shkencore dhe mediatik boterore. Nje pjese e analisteve dhe eksperteve po ashtu edhe sot nuk kane mundur t'i pergjigjen pyetjes se cilet ishin shkaqet qe e shtyne revolucionin Islamik qe ne mes te revolucioneve tjera te jete me i fuqishmi dhe me ndikues?

Ne pergjigje te kesaj pyetje duhet te themi se bota deri tani ka pare shume revolucione, por se te gjithe mendimtaret dhe analistet politik vetem tre prej tyre i shikojne si te medha dhe me ndikim te madh, dhe qe valet e tyre shkuante pertej kufijve te caktuar, duke çuar ne krijimin e levizjeve ne vende dhe shoqeri tjera nderkombtare, si dhe duke ndikuar edhe ne sistemin nderkombtare.

Revolucioni i madh francez ne vitin 1879, revolucioni rus ne vitin 1917 dhe Revolucioni Islamik i Iranit ne shkurt te vitit 1979, jane tre revolucionet me te medha te botes. Por ne kete mes Revolucioni Islamik i Iranit megjithese ka shume gjera te ngjashme me revolucionet tjera te botes, analistet jane te mendimit se ai ka te vecanta te shquara te cilat e bejne ate shume me te shquar se revolucionet e tjera. Nje nder te veçantat me te theksuara te revolucionit Islamik qe ne krahasim me revolucionet e tjera pati nje vend me te veçante ne shoqerine boterore, ishte se ne baze te mendimit krijues dhe te shkelqyer te Islamit u mund te formohet nje shoqeri e re dhe e forte, ne kohen kur te dy revolucionet, edhe ai francez, edhe ai rus ishin kunder fese. Nje tjeter e veçante e shkelqyer e revolucionit Islamik te Iranit ne krahasim me revolucionet franceze dhe ruse ishte fakti se pjesmarrja e popullit ne lufuten me regjimin mbreteror ishte shume e madhe, duke perfshire ketu çdo grup shoqerore dhe klasor nga cdo qytet dhe fshat, qe coi ne largimin e regjimit mbreteror, nderkohe qe ne dy revolucionet e meparshme pjesemarja e popullit nuk ishte shume e madhe.

Ne kundershtim me revolucionet e tjera, populli iranian edhe pas fitores se revolucionit, vazhdoi te merrte pjese masivisht ne cdo fushe apo zgjedhje te ndryshme. Pjesmarrja e madhe e popullit iranian ne cdo lemi, coi ne deshtimin e te gjitha planeve te armiqeve

kunder RII. Nje nder pikat interesante ne dy revolucionet e meparshme, eshte fakti se lideret e ketyre revolucioneve nuk ishin shume te njohur dhe nuk perkraheshin shume nga njerzit e cdo klase apo shoqerie, dhe mbas fitores se ketyre revolucioneve, ne fakt ata kane deshtuar ne vendosjen e sistemit qe deshironin dhe per kete arsy qe lideret e revolucionit rus dhe atij francez perfunduan ne vendosjen e diktatures dhe shtypjes se popullit. Por se populli iranian ne 27 vitet e Revolucionit islamik kane patur ne krye lider kushtetues, ligjore, shoqerore, dhe fetare qe kjo ne fakt eshte nje nga sekretet dhe shkaqet kryesore te qendrueshmerise se sistemit te revolucionit islamik te Iranit. Ne te vertet fitorja e Revolucionit Islamik duhet pare lidhjen e shkelqyer midis lidershipit, popullit dhe mendimit Islamik, dhe qe ne kundershtim me mendimet apo parashikimet e analisteve politik nderkombtare, mundi qe te rrezoje sistemin e fuqishem mbreterore si dhe ne arenen nderkombtare duke menjanuar dy mendimet e fuqishme qe zoteronin luften e ftohte, ate komunist dhe ate liberal-demokrat. Analistet dhe medimtaret politik boterore pranojne faktin se deri me tani, shume pak revolucione ka patur qe rruga drejt te ardhmes se tij te jete e njejte si ne diten e pare te krijimit apo te shfaqjes se tij.

Udheheqesit e fuqishem iranian munden qe ta udhehiqnin dhe ta drejtonin shoquerine dhe popullin iranian ne nje menyre te tille qe ajo ti qendroje besnike slloganeve dhe synimeve te revolucionit, dhe qe njerzit po ashtu te merrnin pjese perseri ne menyre masive ne skenen politike te vendit. Ne kete menyre, qendrueshmeria dhe besnikeria ndaj te gjitha bazave dhe slloganeve kryesore te Revolucionit Islamik kunder te gjitha problemeve dhe planeve armiqsore te huaja, me shume se cdo gje ka lidhje me basnikerine e popullit iranian me vlerat dhe bazat e fese se larte Islame. Ashtu si feja islame e cila eshte feja me e plote qiellore dhe qe kujdeset per jeten ne kete dhe ne boten tjeter te njeriut, edhe revolucioni islamik ne kuader te ruajtjes se vlerave Islamike ka ndikimet e veta te thella dhe te fuqishme te brenedshme, rajonale dhe nderkombtare, dhe se shume prej ideve shkencore, dhe shoqerore te revolucionit sot shikohen ne mardheniet nderkombtare.

Nje prej bazave me te fuqishme te revolucionit, te perseritura disa here, eshte lufta dhe qendrueshmeria ndaj imprealisteve. Qeveritaret amerikan te cilet ne baze te pikpamjeve perendimore deklarojne se revolucionet disa koha pas fitores se tyre fillojne te marrin distance nga slloganet e tyre, kishin shprese qe edhe me revolucionin islamik te perseritej e njejtë gje. Por ashtu sic e ka theksuar edhe hazreti Ajetullah el Udhma Khamenei, lideri suprem i revolucionit islamik te Iranit: Populli iranian me nje deshire te madhe eshte simpatizues i madhe i islamit dhe shpreson ne mbeshtetjen hyjnore dhe ne shpresen e nje fuqie te bashkuar kombetare, per te ruajtur dhe forcuar slloganet dhe mendimet baze te revolucionit Islamik dhe te bashkuar rreth mendimeve dhe urdherave hyjnore te bashkuar, munden qe te qendrojne perballë cdo lloj plani apo synimi agresiv te imprealizmit boterore, dhe me urtesi dhe vigjilence munden qe te ndermarrin hapa te medha ne drejtim te lirise dhe pavarsise politike te tyre. Ne kete kuader ne baze te thenieve te liderit suprem te revolucionit islamik te Iranit hazreti Ajetullah el Udhma Khemenei, populli i zgjuar, me talent, me pervoje dhe i pavarur iranian, mundet qe levizjen e fuqishme boterore ta drejtoje kunder sistemit Imprealist.

## **Arritjet e Revolucionit Islamik ne sferen ekonomike dhe ndertimore**

Fitorja e Revolucionit Islamik te Iranit, shikohet si nje pike e fillimit te ndryshimeve dhe zhvillimit ne fusha te ndryshme, dhe ngjalljes se vlerave te fuqishme kulturore dhe islamike. Aktualisht megjithese kane kaluar me shume se 27 vjet nga fitorja e revolucionit islamik dhe vendosjes se sistemit Islamik te Iranit, eshte arritur nje perparim i madh ne sferen ekonomike qe disa vite me pare arritja ne kete drejtim ishte shume e veshtire dhe se shume analiste politik e shikonin ate si nje hap te madh perpara. Por se Republika Islamike ne baze te vetbesimit, perpjekeve dhe devotshmerise se madhe dhe te palodhshme te popullit iranian, e vendosi dijen dhe shkencen si baze te zhvillimit dhe ne shume fusha shkencore, industriale, mjeksore e bujqesore pati zhvillime dhe perparime te konsiderueshme. Deri perpara fitores se Revolucionit Islamik ne Iran, ekonomia e vendit ishte e bazuar tek te ardhurat nga nafta dhe per kete arsyen vendi nga ana e prodhimit dhe zhvillimit te brendshem kishte ngelur shume mbrapa, ne menyre qe shumica e nevojave te brendshme te vendit vinin nga importi i mallrave te huaja. Por nga ana tjeter, nafta dhe shume lende te para duke mos shtuar vleren e tyre eksportoheshin jashtë vendit. Ky veprim e kishte shnderruar ekonomine iraniiane vetem ne nje element dhe ne nje treg me shpenzime duke thithur shume mallra te huaja. Por kjo gje, pas fitores se revolucionit islamik, u nderrua per shkak te dy shkaqeve, pra te ndryshimt te sistemit ekonomik te Iranit, dhe e dyta vendosja e bllokades ekonomike ndaj RII dhe lufta e imponura nga regjimi Bath i Saddam Husejin. Kjo ne nje menyre te tille sa qe shume produkte industriale qofte edhe ato me te thjeshtat filluan te zhdukeshin nga tregu.

Kjo ecuri, per nje kohe te kufizuar coi ne nderprerjen apo kufizimin e fabrikave te cilet lenden e pare e merrnin nga jashtë, duke cuar keshtu ne nje presion dhe ndikim te madh tek konsumatoret. Por keto probleme dhe kjo shtengese, duke patur parasysh ketu edhe synimet e Revolucionit Islamik per pavarsine dhe lirine e popullit iranian dhe me perpjekje dhe mundime ne nderprerjen e lidhjeve me jashtë, u be shkak qe te filloje nje levizje e madhe vullnetare dhe e per gjithshme per zgjidhjen e problemeve dhe nevojave ekonomike te vendit. Ne te vertet kombi iranian me vetbesim, duke patur nje shpirt te forte dhe duke perdorur fuqine e madhe rinore dhe profesionale te saj, coi ne fillimin e prodhimit dhe zgjidhjen e kerkesave te brendshme. Kjo levizje megjithese ne fillimet e saj ishte e dobet dhe me probleme, me kalimin e kohes u shnderrua ne nje besim dhe kerkese kombetare dhe u vendos ne kuader te programit 5 vjecare te zhvillimit ekonomik, shoqerore dhe kulturor te vendit menjhere pas luftes se imponuar. Pervoja e pare e Iranit ne sferenen ekonomike ishin rindertimet e shkaterrimeve te bera nga lufta e imponuar, gje qe u zbatua me sukses. Menjehere pas kesaj, filloi periudha e dyte ne programin e zhvillimit, duke u vene ne plan gjetja e fushave te zhvillimit dhe progresit ekonomik, gje qe vazhdoi edhe ne programin e trete te zhvillimit. Nder rezultatet me te rendeishme te programeve 5 vjecare, te dyte dhe te trete ekonomik te zhvillimit kulturore dhe shoqerore, ishin ne fushat industriale dhe bujqesore. Ne pjesen e industrise se burimeve natyrore pati nje zhvillim prej 10 %, dhe beri te mundur nje ecuri dhe zhvillim ne industrite e vogla. Keto zhvillime dhe ne vecanti industrite e lidhura me naften dhe gazin sic eshte petrokimia dhe ndertimi i rafinerive, si dhe fillimi i ndertimit te fabrikave per shkrirjen e metaleve dhe fabrikat per prodhimin e çimentos etj, coi ne qendrueshmerine dhe forcimin e ekonomise se Iranit. Kjo beri qe Irani te shnderrohet nga nje vend me ekonomi te varur nga te tjeret, ne nje vend i cili jo vetem qe posedon

dije te perparuar per qarkullimin e lendet dejegese berthamore, por edhe te eksportoje sherbime teknologjike dhe ndertimore ne vendet tjera. Irani ne fushen e ndertimit te veprave te medha tashme ka arritur ne pavaresi duke permbushur nevojat e brendeshme, nderkohe qe ka filluar ndertimin e dhjetra rrugeve, urave si dhe shnderimin e rrafshnaltave dhe gjysem shkretirave ne vende pjellore, si dhe ne ate te ushqimit, dhe nderkohe qe nga ana tjeter ai ka filluar edhe eksportimin e produkteve apo teknologjise petrokimike ne vendet e tjera. Kjo ecuri e cila ka qene ne te gjithe programin e zhvillimit 20 vjecare te RII, mund te beje qe sistemi i RII si nje permbledhje efektive duke u mbeshtetur tek populli dhe qeveria, te mund te caktoje poziten e vertete dhe meritore te popullit Iranian ne sferat ekonomike.

### **Irani depi i zgjimit te botes Islamë**

Nje nga aspiratat e sistemit te Republikes Islamike te Iranit eshte dhe zgjimi i botes islame. Revolucioni islamik qe nga fillimet e formimit te tij, ka qene i bazuar mbi ngritjen dhe zgjimin islamik. Zgjimi islamik ka kuptimin e rifitimit te pavarsise, ruajtjes se vlerave fetare dhe kulturore, dhe mohimin e sundimit te te huajve. Fitorja e revolucionit islamik ne Iran e arri kete qellim. Por, duke pare se fati i botes islame ka ngecur ne hallka te ndryshme dhe ummeti islam perball me kercenime te perbashketa, eshte e nevojshme qe te gjithe muslimanet te bashkepunojne me njeri-tjeterin perball ketyre kercenimeve te cilat kane si shenjester indentiten, lavdine dhe pavarsine e muslimaneve. Por, per fat te keq edhe bashkepunimi ne boten islame has ne sfida te ndryshme si psh. diferençimi midis shteteve islamike. Pavec kesaj, ata hasin dhe probleme te shumta si pasoje e imponimit te politikave te superfuqive boterore mbi boten islame. Ketu mund te permendim pabarazine ne sistemin ekonomik boteror, si dhe rrembimin e burimeve dhe pasurive te shteteve te varfera, dhe presionet mbi shtetet qe kerkojne pavaresi dhe progres. Por per kunder ketyre problemeve, dhe pranine e levizjeve per pavarsi dhe kundershtimeve te tyre gjate dy dekadave te kaluara, zgjimi islamik eshte rritur me shume. Shembulli i ketij zgjimi eshte lindja e mesme. Rajon i cili gjate ketij gjysem shekulli ka qene bere perhere pre e interesave per energji nafte dhe gazit te politikave te superfuqive boterore. Pas fitores se Revolucionit Islamik te Iranit ne shkurt te vitit 1979 nje nga shqetesimet e superfuqive boterore ka qene berja shembull e revolucionit islamik dhe sistemit demokratik popullor fetar te republikes islamike te Iranit per shtetet e tjera liridashese. Ndikimet e shumta te revolucionit islamik tani jane kthyer ne nje realitet frikesues per fuqite kolonizatore. Ne fakt qe ne fillim te fitores se revolucionit islamik te Iranit armiqte filluan sulmin e tyre per irrezimin e sistemit te republikes islamike dhe filluan me provokimin e elementeve te ketyre fuqive ne rajon kunder Iranit si lufta e imponuar, embargoja ekonomike dhe sabotimet ne mardheniet e Iranit me shtetet e tjera me qellim te izolimit te Iranit. Por kombi Iranian jo vetem qe nuk u dorezua perball armiqve te revolucionit, por ai u be shembull per ummetin e islamit. Qendresa e kombeve te rajonit si psh. Palestina dhe Libani perball politikave agrsive te regjimit sionsit dhe kundershtimi me politikat amerikane si dhe shtimi i urejtjes ndaj qeverise amerikane jane rezultate te zgjimit islamik. Sipas liderit supreme te revolucionit islamik superfuqite kane arritur ne kete perfundim se lindja e mesme eshte vatra e zgjimit islamik dhe nese nuk do ta parandalojne ate atehere te gjitha ekuilibrat dhe interesat e deri tanishme te tyre ne lindjen e mesme do te shemben. Per kete arsyte te gjithe superfiqtë kolonizuese perpiqen qe se bashku t'i bejne balle zgjimit dhe bashkimt te muslimaneve. Ku republika

islamike e Iranit eshte djepi i ketij zgjimi. Perballja e superfuqive me zgjimin islamik nuk ka qene vetem ne menyre te drejte per drejte dhe pushtuese, por, ata duke pasur parasysh pervojen e se kaluares dhe veshtiresite e hasura ne Irak te cilat jane tregues te qendreses se ummetit islam perballle agresoreve, kane perdonur menyra te ndryshme si krijimi i nje sistemi mashtrues demokratik, lirite e politikes mbrojtja e te drejtave te njeriut dhe lufta ndaj zhdukjes e armeve te shkatrimit ne mase. Qellimi kryesor i superfuqive boterore eshte ndalimi i botes islame qe ajo te arrije besimin ne vetvete zhvillim dhe pavarsi e te qendroje ne prapambetje dhe varsi politike. Per kete arsy Amerika sistemin e republikes islamike te Iranit qe eshte shembull i demokracise fetare te mbeshtetur ne vetbesim, lavdi, progres dhe pavarsi te kombit iranian e shikon si pengesen kryesore te rruges se saj per te shtuar zgjerimin e synimit te saj ne rajon. Ne fakt ndikimi i Revolucionit Islamik te Iranit mbi kombet e tjera boterore ka ngritur nje dige te madhe ne rrugen e interesave te superfuqive boterore dhe kjo gjendje rrjedh nga roli i Revolucionit Islamik ne zgjimin islam dhe bashkepunimin e botes islame. Lideri suprem ne deklaraten e fundit te tij me rastin e festes se Gadirit eshte shprehur se vullneti i kombeve dhe qeverive behet shkak i shkuljes se gjembit te kolonizatoreve.

### **Sistemi popullor fetare nje element e vertet i demokracise**

Dy te vecantat e rendeishme te revolucionit islamik te Iranit ishin bazat e saja Islamike dhe Popullore ne kete kuader sistemi i kerkuar nga ky revolucion mori emrin Republika islamike ku ne te populli vepron lirisht e ne kuader te rrugeve te dhena nga islam, dhe se populli me kerkesen e vet kerkoi qe Islami te jete percaktues per fatin e tyre dhe kjo pasi vinte nga mprehtesia e tyre se ne kete kuader atyre u ishte dhene edhe miresia e kesaj bote dhe ne ate tjetren dhe se i jep nje rendesi te vecante rolit te popullit ne caktimin e fatit te vet. Vetem pak kohe pas fitores se revolucionit islamik Imam Khomeini (ra) e ftoi te gjithe popullin Iranian ne nje referendum. Populli i cili ne takime dhe demostrata te ndryshme kishtet kerkuar venien e nje sistemi islamik ne Iran ne kete referendum me pjesmarjen e madhe te tyre kerkuan vendosjen e sistemit te Republikes islamike.

Ne te vertet duhet te themi se ne mesimet islamike theksuhet shume ne lidhje me nderhyrjen e popullit ne caktimin e fatit te tyre. Kjo fe ka kerkuar nga njerzit qe te marrin pjese ne pune te ndryshme dhe te shprehin edhe mendimin e tyre duke i dhene nje rendesi te madhe mendimit te tyre. Zoti i Madherishem ka kerkuar nga profeti (s) qe te keshillohet me njerezit ne pune te ndryshme dhe ne Suren Shura nder epitet e besimtareve cileson keshillimin dhe nje mendjen. Nder mesimet e islamit per ti dhene nje ndikim te popullit ne fatin e tyre eshte edhe fakti se Zoti i Madherishem ka kerkuar nga njerezit dhe besimtaret qe te mos rine indiferent e kundrejt atyre qe ndodhin pereth tyre dhe te tregohen te ndergjegjshem ne lidhje me zhvillimet dhe ngjarjet pereth. Respektimi i kesaj baze dhe sidomos ne lidhje me zyrtaret qeveritare dhe ata sundues dhe kjo ne kuptim se njerezit duhet te jalin mendimin e tyre ne lidhje me veprimet e liderve te tyre dhe atje ku eshte e nevojshme duke perdonur mjetet e duhura te reagojne ndaj gabimeve te tyre.

Islami e njeh ne menyre zyrtare Lirine e njeriut, nderkohe qe te medhenjte e fese e kane theksuar disa here ne lidhje me lindjen dhe qenien te lire te njeriut dhe se liria eshte nje e drejte natyrore e Njeriut. Po ashtu ne fene islame eshte e pa pranueshme fakti i pranimit te fese me force dhe dhune dhe se cdo njeri eshte i lire qe te zgjedhi vet rrugen

e tije. Kur'ani i shenjte ne ajetin 256 te sures Bakare deklaron: *Ne fe nuk ka dhune, rruga e udheheqjes nga eresia eshte e qarte.*

Ne kete menyre duhet te themi se ata te cilet i pranojne mesimet e fese islame per jetesen e tyre rrjedh nga fakti se ata i shikojne keto mesimi si te urta dhe te llogjikshme dhe se me to veprojne me deshire dhe me vullnetin e tyre.

Por ne lidhje me fjalen Liri ne fene islame, mund te themi se ajo eshte e perdonur ne nje menyre te tille qe te mos kete keqperdorim te saje dhe qe te mos behet pengese e zhvillimit dhe progresit te njeriut. Me fjale te tjera Liria dhe vetvendosja e popullit ne sistemin Popullior Islamik eshte e vendosur ne kuader te ligjeve dhe vlerave te thena me larte dhe ne zemer te sistemit fetare dhe popullor islamik.

Sistemi Popullor fetare e sheh veten si nje forme e veprimit te vetvendojes se popullit. Ajetullah Khamenei Lideri Suprem i RII ne perkufizimin e sistemit popullor fetare deklaron: Sistemi popullor fetare domethene votat e popullit ne kendveshtrimin e Islamit dhe me te njejtin respekt per te clen feja islame vendos per voten e pollit dhe per ndergjegjen e tyre. Feja islame i ka dhene nje perqjigjesi te madhe sundimtareve ne lidhje me popullin. Feja ne fakt nuk pranon ne asnje menyre sistemin diktatorial dhe shtypes. Lideri Suprem ne mesazhet e tija te ndryshme deklaron: Sistami Popullor fetare nuk eshte demokracia perendimore me njyre islami pasi sistemi popullor fetare eshte ne baze te kerkesave vlerave dhe mesimeve te islamit.

Nga pikpmaja e qeveriave dhe medias perendimore e vetmja menyre e vendosjes se sistemit demokratik eshte demokracia perendimore. Por ne kundershtim me mendimet dhe pikpmajet e tyre vetvendosja e popullit mund te kete rruge dhe menyra te vecanta ku sistemi popullor fetar eshte nder me te pershatshimit prej tyre. Ne kete sistem ne krahasim me sistemet e tjera ka me pak shperdorime te Lirise. Pasi ne kete sistem ka disa koncepte dhe elemente te caktuara te cilat parandalojne devijimet. Ne baze te ketyre koncepteve nje njeri i lire eshte i lidhur me pikpamjet edukative. Ne kete menyre qe nje person nuk i lejon vetes qe te shkele te drejten e nje personi tjeter apo te sulmoje nje vend tjeter. Ne kete menyre ne mund te themi se mesimet e fese islame jane ne kuader te rregullimit dhe te interesit te vertete te njeriut duke cuar keshtu ne Lirine se bashku me nje edukate te shendoshe.

Por ne demokracine Liberale te perendimit, liria nuk ka kufi dhe mbarim dhe ne shume vende ajo keq shperdorohet. Ne vendet perendimore megjithese ekziston liria ne shume raste ajo eshte ne kuader te interesave personale dhe pa vlera dhe ka dallime me interesin dhe kerkesat e njerzimit. Po ashtu kjo Liri perdoret ne kundershtim me interesat dhe synimet e njerzimit dhe ne emer te saje behen shume veprime te pa pranueshme. Kjo ne menyre qe nje pjese e mire e veprimeve jo humane tashme ne perendim eshte kthyer ne nje Ligj Kushtetues. Nje nder to eshte njobja zyrtare e Homoseksualitetit dhe veprimet jo te ligjsme seksuale.

Nga ana tjeter zgjedhjet jane nje nga mjetet me ligjore per marrjen pjese te popullit ne jeten politike. Kjo menyre aktualishte eshte nder menyrat me te mira te njobura deri tanj per pjesmarrjen e popullit ne te ardhmen e vet. Ne sistemin popullor fetare njerzit votojne duke e njobur mire me pare ne kandidat politik duke u larguar nga manipulimet mashtrimet apo rryshfet me leke pasi keto lloj menyrash e heqin ligjshmerin e zgjedhjeve. Ne sistemin popullor fetare ekzistojne disa koncepte dhe elemenete qe njerzit duke i kushtuar vemendje atyre zgjedhin presidentin, deputetet e parlamentit apo edhe kandidatet e keshillit bashkiak. Roli i Udheheqsit ne Sistemin popullor fetar po ashtu eshte shume e madhe. Nder to edhe veprimet e tije cojne ne krijimin e

mekanzimave te cilat bejen qe zgjedhjet te jene pozitive dhe te fryshtme dhe ruajtjes se votes se popullit ne menyre qe te zgjidhet nje njeri i mire dhe me vlera.

Por ne sistemin demokratik perendimore ne zgjedhje te ndryshme fjalen e pare e kane te pasur apo lobet e investitoreve.Cdo kandidat qe ka leke dhe nje pozite me te mire mundet qe te kete me shume reklame elektorale dhe me mashtime te ndryshme te marri voten e popullit. Kjo ne fakt eshte nje blerje e votes se popullit me menyra te reja. Ne fakt zgjedhjet e fundit presidenciale te SHBA treguan me se miri kete dhe blerjen e votes se popullit, ne menyre qe Xhorxh W Bush per rizgjedhjene dyte te tije ka shpenzuar me shume se 250 milion\$. Po kjo teme duke i shtuar edhe propagandat hallakatese te medias Amerikane u be shkak qe ai te qendroje per te dyten here ne presidencen Amerikane. Kjo ne kohen kur Bush ne periudhene pare te presidences se tije shkaktoi shoqerise boterore i dha lufte mjerim gjakderdhje dhe popullit Amerikan pa sigurise dhe rinie ekonomike. Per kete arsy qe nje pjese e mire e shoqerise boterore shprehen keqardhjene tyre ne lidhje me rizgjehjen per te dyten here te Bushit ne postin e presidentit Amerikan.

Aktualisht kur kane kaluar me shume se 27 vjet nga revolucioni islamik populli iranian ka shkuar me shume se 20 here ne menyre te lire ne kutite e votimit per te zgjedhur lideret e saje duke qene keshtu nje shembull i mire i sistemit populor fetare. Ata ne menyre te lire dhe te vullnetshme zgjodhen presidentin e tyre. Ne te vertet nder perfitimet me te medha te revolucionit islamik eshte sistemi populor fetare e cila perben shembullin dhe bazen me te mire te demokracise per popujte e tjere Muslimane.

## **Themelet e mendimit te Revolucionit Islamik**

27 vjetori i revolucionit islamik fillon ne kohen kur ky revolucion ka kaluar faza krizash dhe sulme te shumta. Tani ky revolucion eshte fiksuar si nje levizje e qendrueshme dhe popullore ne bote. Ajo gje e cila revolucionin islamik e ka nxjerre kokelarte nga mesi i intrigave te shumta te armikut e qe kalon si nje fllad i fresket neper mendjen e opinionit boteror eshte natyra e vlerave dhe themelet e ketij revolucioni. Gje e cila qe ne fillim e ka dalluar kete revolucion nga revolucionet e tjera boterore. Revolucioni islamik u realizua ne nje kohe kur politikanet ne shtete boterore lumturine e njeriut e quanin si te vetmen frysht te materializmit dhe interesit personal. Me kete pikpamje morali dhe indetiteti i njeriut shkoi drejt harreses. Revolucioni islamik per kunder kesaj levizjeje mendore paraqiti kthimin drejt vvetes, duke e ftuar njeriun drejt vlerave te tij. Zeri i revolucionit islamik thonte qe njerezit te mos rrin qe mbyllur perballë vlerave te larta njerezore dhe te perpiqen per te vazhduar rrugen e profeteve te medhenj hyjnor si hz. Musai a.s., Isaut a.s. dhe Muhammedi s.a.v.s. per te pasur dhe ne te njeten kohe duke perdorur teknonologjine e re ne kuader te permiresimit te jetes dhe lumturise. Sot ne boten kur njeriu kerkon nje levizje drejt moralit dhe spiritualitetit ky aspekt shpirteror i revolucionit islamik i fal atij freski dhe shpaloset si nje levizje me ide te reja dhe rrugezgjidhje te shumta perballë kombeve. Mishel Fuko, teoricien francez lidhur me kete thote: shpirti i revolucionit islamik gjendet ne kete realitet se iranianet ne kuader te revolucionit kerkonin krijimin e ndryshimit ne vvetete. Qellimi kryesor i tyre ishte krijimi i nje ndryshimi rrenjesor ne ekzistencen personale dhe shoqerore jeten civile dhe politike si dhe ndryshim ne mendim. Iranianet perpiqeshin ne shkaterrimin e pervojaqe dhe menyren e jetes se tyre e ne kete menyre gjeten menyren e reformes ne islam. Islami per ata ishte dhe nje ilac personal por edhe nje ilac per sherimin e masave shoqerore. Ne fjalimin e Fukos shikojme natyren kryesore te revolucionit islamik ku

eshte theksaur te qenurit islamik te tij. Revulucioni islamik duke u bazuar tek Zoti, duke u mbeshtetur tek mendimet e larta islame keto mendime i beri te besueshme per boten, se islami si feja me e plote mund t'i fale lumturi jetes se njeriut. Sot bota ka kuptuar se islami nuk eshte vetem forme e rregullave morale por ai eshte dhe formues i jetes njerezore. Islami mund te themeloje nje pushtet i cili te siguroje interesat materiale shpirterore te njeriut dhe njekohesisht me mireqenien materiale t'i fal njeriut qetes shpirterore dituri dhe dije. Na baze te kesaj revulucioni islamik duke u frymezuar nga mesimet e islamit i kushton vemendje nevojave shpirterore dhe vlerave morale te njeriut dhe nga ana tjeter ne turmat e njerezve ai perforteson besimin fetar duke u mesuar atyre besimin ne vetvete. Ne kete menyre revulucioni dha nje imazh te pershtatshem te islamit lidhur me kushtete e kohes dhe ky veshtrim i ri tregoi se me kundershtim me mendimet e disa dijetareve dhe sociologve perendimor shoqeria njerezore nuk mund te ece drejt sekularizmit. Revulucioni islamik ne themelin e pushtetit fetar i vuri nen ndikim popujt e botes. Nje nga vecorite e tjera te revulucionit islamik eshte dhe te qenit i pavarur i tij. Revulucioni islamik u ngrit ne baze te mohimit te sundimit te superfuqive boterore dhe po ashtu po e vazhdon kete rruge. Ky revulucion qe nga ditet te fillimit te levizjes se miliona njerezve kunder regjimit te mbretit pati si qellim politik te tij pavarsine lirine dhe shkeputjen nga sundimi i lindjes dhe perendimit. Ky qellim u paraqit nen parrullen as lindje as perndim vetem republike islamike. Dhe pas fitores se revulucionit u vazhdua e njejtë rruge edhe ne mardheniet e jashtme te Republikes islamike te Iranit. Mohimi i sundimit rrjedh nga thellesia e besimeve islamike. Ne baze te mesimeve islamike eshte e nevojshem besimi ne Zot si dhe mohimi i pushtetit te pafeve shtypesve dhe agresoreve. Ne Kur'anin e Madherishem ne surene Nisa ne ajetin 141 thuhet: *Zoti kurre nuk i ka dhene rruge sundimit te pafeve mbi besintaret.* Tani, sot kalojne 27 vjet ngajeta e revulucionit islamik dhe beteja me superfuqite sunduese akoma do te mbetet qellimi kryesor i revulucionit. Cdo kush e di qe nese republika islamike e iranit do ta u le koken perballje superfiqve te huaja shume prej problemeve te tanishme nuk do te lindin, por duke ditur se ruajta e pavarsise dhe ecja drejtë lirise eshte vlore e panderrueshme dhe e pelqyeshme per cdo njeri te lire populli iranian per kunder te gjithe ketyre presioneve nga ana e armikut qendron koke lart. Ne kuader te ndikimit te kesaj qendrese edhe muslimanet e botes tani po u bejne qendrese pushtimit dhe agresionit. Revulucioni islamik duke u mbeshtetur ne besimin tek Zoti u ka treguar popujve te botes rrugen e lavdise dhe nderit dhe ka treguar se per te arritur ne liri dhe madhetine njerezore asnje arme nuk eshte me e fuqishme sesa besimi ne vetvete. Rafael Gomespara gazetar spanjoll revulucionin islamike quan nje ndryshim themelor ne menyren e te luftuarit, dhe thote revulacioni islamik e ka provuar se arritja e lirise dhe zhvillimi i kombeve te botes se trete eshte i mundshem vetem ne besimin ne Zot dhe luftimin direkt te ideve individualiste dhe egoiste te botes perendimore. Perpjekjet per zgjerimin e drejtesise dhe lufta ndaj shtypjes jane nga themelet e tjera te revulucionit islamik. Drejtesia zhduk dallimet klasore dhe shperndan ne menyre te drejte mundesite dhe te ardhurat dhe njerezit perfitorje kushte te perbashketa per zhvillimin dhe shpalosjen e talenteve vetiake. Ajetullah Homeini duke theksuar mbi drejtesine ne revulucionin islamik thote cdo levizje drejtesie njerezore eshte nje mase e marre drejte vendosjes se ligjit dhe ecurise natyrore te botes, ne baze te kesaj edhe kombi i madh iranian qe nga kohe kur vuri kembe ne skenen e betejes drejte lirise stabilitetit dhe drejtesise.

Sa me shume qe kalon mbi jeten e revulucionit islamik te gjithe behemi deshmitar se ky revulucion e ndjek rrugen e zhvillimit te tij pa ju shmangur ketyre rregullave. Nga ana

tjeter ekspansionistet boteror sidomos shtepia e bardhe thurin intriga pa ndalim per te parandaluar mendimet e larta te islamit dhe idealet e revolucionit islamik. Por ne kundershtim me propaganden anti islame dhe sulmet kunder islamit, islami e ka hapur vendin e tij ne zemrat e njerezve dhe levizja e pavarsise se revolucionit islamik u jep shembuj dhe drite kombeve te tjera te botes.

## **Progresi shkencor dhe teknik i Iranit ne kuader te Revolucionit Islamik**

